



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY



# UDHËZUES PRAKTIK PËR AUTORITETET PËRGJEGJËSE LIDHUR ME PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE



SHTYPJA E KËTIJ UDHËZUESI ËSHTË MUNDËSUAR NGA BYROJA PËR ÇËSHTJE NDËRKOMBËTARE TË NARKOTIKËVE DHE ZBATIMIT TË LIGJIT (INL) NË AMBASADËN AMERIKANE NË PRISHTINË.

Agjencia Kundër Korrupsionit

Prishtinë, Shkurt 2020 | Rr. Nazim Gafurri nr. 31, 10000, Prishtinë, Kosovë

## *Përmbajtja*

---

Përmbledhje Ekzekutive.....	2
Autoritetet Përgjegjëse dhe subjektet juridike për të cilat vlejné dispozitat e ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit.....	3
Obligimet e Autoriteteve Përgjegjëse.....	4
Veprimet e Autoriteteve Përgjegjëse .....	5
Detyrat dhe përgjegjësitë e Autoriteteve Përgjegjëse .....	7
Kufizimet për zyrtarët e lartë publik dhe masat parandaluese të institucioneve publike.....	8
Veprimet e Autoriteteve Përgjegjëse gjatë trajtimit të rasteve.....	11
Burimet e informacionit dhe verifikimi i tyre.....	12
Veprimet e Autoriteteve Përgjegjëse në rastet e konfliktit të interesit.....	14
Identifikimi, trajtimi, deklarimin dhe regjistrimi ‘rast për rast’ i rasteve të konfliktit të interesit nga Autoritetet Përgjegjëse.....	15
Raportimi në Agjencinë Kundër Korrupsion .....	16
Roli Agjencisë Kundër Korrupsion në raport me Autoritetet Përgjegjëse.....	17
Përdorimi i formularëve .....	18
Shtojcat e bashkangjitura.....	19

## *Përmbledhje Ekzekutive*

---

Udhëzuesi praktik për Autoritetet Përgjegjëse në Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Institucionet Publike ofron udhëzime dhe sqarime për autoritetet përgjegjëse, se si t'i përcaktojnë rregullat, procedurat, detyrat dhe cilat janë përgjegjësitë e tyre karshi obligimeve që dalin nga dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik [këtu e tutje "Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit"].

Ky udhëzues përmban përmbledhjen bazë të kornizës ligjore të cilat kanë për qëllim lehtësimin dhe ofrimin e propozimit për hartimin e rregullave për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit brenda institucionit, konform Ligji për parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Udhëzuesi është përgatitur në kuadër të asistencës profesionale që Agjencia Kundër Korrupsionit ofron për të gjitha institucionet publike – të referuara si Autoritete Përgjegjëse me Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, në mbështetje të Nenit 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.8, të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Nenit 20 dhe Nenit 21 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Përveç sqarimeve që përmban ky udhëzues, Agjencia Kundër Korrupsionit ofron bashkëpunim të vazhdueshëm me autoritetet përgjegjëse në funksion të zbatimit të drejtë të dispozitave të Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit si dhe rregullativës së brendshme të institucioneve publike. Një qasje e tillë është më e arsyeshme dhe më efektive se modelet tjera të parandalimit të konfliktit të interesave, p.sh. përqendrimi i të gjitha detyrave në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesit në duart e një institucioni. Kjo mundëson që situatat të kontrollohen më mirë dhe të parandalohet konflikti i interesit në burim.

Ky është Botimi i Parë i këtij udhëzuesi i hartuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit me të cilin synohet të mbështeten autoritetet përgjegjëse në punën e tyre, për identifikimin, trajtimin si dhe zgjidhjen e situatave të mundshme të konfliktit të interesit. Prandaj, si i tillë, varësisht nga sfidat apo problematika e paraqitur nga Autoritetet Përgjegjëse, Agjencia Kundër Korrupsionit ka të drejtë të rishikoj, ndryshoj, tërheq apo plotësoj këtë Udhëzues me qëllim të avancimit konform nevojave që mund të paraqiten gjatë procesit të punës. Ky udhëzues mund të shërbej për hartimin e akteve nën-ligjore konform Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në pajtim me udhëzimin administrativ për Standardet e Hartimit të Akteve Normative.

## *Autoritetet Përgjegjëse dhe subjektet juridike për të cilat vlejnë dispozitat e ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit*

Në mbështetje të paragrafit 1, të Nenit 20 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se Agjencia Kundër Korrupsionit është autoriteti qendror përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji, por jo institucioni i vetëm. Ky ligj ka përcaktuar se të gjitha institucionet publike, duke përfshirë dhe ndërmarrjet publike qendrore dhe lokale, janë përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit.

Sipas paragrafit 2 të Nenit 20 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se autoritetet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji në institucione janë:

- udhëheqësit e drejtpërdrejtë të zyrtarëve, sipas hierarkisë, brenda një institucioni;
- institucionet dhe autoritetet udhëheqëse sipas ligjit.

Prandaj, përkufizimi i termit “Autoritet Përgjegjës” nënkupton (1) udhëheqësit e drejtpërdrejtë të zyrtarëve dhe (2) institucione dhe autoritete të tjera udhëheqëse sipas ligjit për rastet kur atyre iu është besuar kompetenca për të shqyrtuar rastet e konfliktit të interesit.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit përcakton parimet, rregullat dhe procedurat lidhur me sjelljet e lejuara dhe të ndaluara të zyrtarëve gjatë kryerjes së detyrës publike si dhe masat e parapara për shkeljen e dispozitave të përcaktuara në këtë ligj. Më tej, bazuar në paragrafin 1, nën-paragrafin 1.3, nën-paragrafin 1.4, dhe nën-paragrafin 1.5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ky ligj zbatohet për të gjithë zyrtarët publik dhe përfshinë: zyrtarët e lartë<sup>1</sup> dhe personat zyrtarë<sup>2</sup>, të gjithë të referuar si zyrtarë apo zyrtarë të lartë përshtatshëm.



### LIGJI ZBATOHEP PËR:

- ⇒ TË GJITHA INSTITUCIONET PUBLIKE - PËRFSHIRË EDHE NDËRMARRJE PUBLIKE QENDRORE DHE LOKALE
- ⇒ TË GJITHË ZYRTARËT PUBLIKE

<sup>1</sup> Të përcaktuar me ligjin përkatës për deklarinim e pasurisë.

<sup>2</sup> Çdo person tjetër të zgjedhur ose të emëruar në një organ shtetëror si edhe personat zyrtarë të përcaktuar sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës që ushtrojnë detyra publike.

## *Obbligimet e Autoriteteve Përgjegjëse*

---

Paragrafi 3 i Nenit 20 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ka përcaktuar se të gjitha institucionet në kuadër të aktiviteteve të tyre të brendshme përcaktojnë dhe zbatojnë rregulla të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit.<sup>3</sup> Në mbështetje të kësaj baze ligjore të gjitha Autoritetet Përgjegjëse<sup>4</sup>, që përfshinë të gjitha institucionet publike, duke përfshirë dhe ndërmarrjet publike qendrore dhe lokale, janë të obliguara të kenë të miratuara aktet e tyre nën-ligjore të veçanta për qëllime të parandalimit të konfliktit të interesit. Konform Nenit 2 të Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit janë përcaktuar gjithashtu procedurat për detyrimet e raportimit, masat për parandalimin, identifikimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesit publik dhe private të zyrtarit gjatë dhe pas ushtrimit të detyrës publike si dhe detyrat e përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse.

Të gjitha institucionet publike, duke përfshirë dhe ndërmarrjet publike qendrore dhe lokale - Autoritetet Përgjegjëse, përveç përcaktimit të rregullave të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit, në mbështetje të paragrafit 4, të Nenit 20 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, në aktin e tyre nën-ligjore janë të obliguar të përcaktojnë procedurën, mënyrën dhe rregullat në lidhje me:

- ⇒ Mbledhjen dhe pranimin nga burime të ligjshme informata për interesat privatë të një zyrtari, përfshirë të dhënat publike ose private, informatat e ofruara nga media dhe ankesat e qytetarëve sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e informatorëve dhe çdo dispozitë tjetër ligjore në fuqi;
- ⇒ Verifikimin e besueshmërisë së burimeve dhe informatave për të vërtetuar konfliktin e interesit;
- ⇒ Vënien në dijeni të zyrtarit për informatat e siguruara për të dhe që përbëjnë shkak për konflikt të interesit dhe dhënien e mundësisë të provojë të kundërtën nëse kjo kërkohet nga zyrtari;
- ⇒ Të njoftoj me shkrim raportuesin brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për shqyrtimin e mëtejme të informatës.

---

<sup>3</sup> Paragrafi 3, Neni 20 i Ligjit Nr. 06/L-011: *“Institucionet në kuadër të akteve të tyre të brendshme, parashohin dhe zbatojnë rregulla të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit, varësisht fushëveprimit të institucionit përkatës”.*

<sup>4</sup> Sipas nën-paragrafit 2.1 dhe 2.2, të Paragrafit 2, të Nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L-011: *Autoritete Përgjegjëse për zbatimin e Ligjit Nr. 06/L-011 në institucione janë: 1. Udhëheqësit e drejtpërdrejtë të zyrtarëve, sipas hierarkisë, brenda një institucioni; dhe 2. Institucionet dhe autoritetet përgjegjëse sipas ligjit.*

## *Veprimet e Autoriteteve Përgjegjëse*

---

Në të gjitha institucionet publike, duke përfshirë ndërmarrjet publike qendrore dhe lokale, kërkohet që të miratohen akte juridike nën-ligjore (Rregullore, Udhëzime Administrative, apo akte me fuqi juridike të tillë) me qëllim të përcaktimit të rregullave të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit brenda institucionit të tyre, konform natyrës së punës dhe fushë-veprimtarisë së institucionit.

Në aktin e tyre juridike për qëllimet e parandalimit të konfliktit të interesit dhe trajtimit të rasteve të konfliktit të interesit, Autoriteti Përgjegjës kërkohet që t'i referohet dispozitave të ligjit për konfliktin e interesit. Në pjesën e parë të aktit nën-ligjor të fokusohet tek përkufizimet, fushë-veprimtaria e aktit dhe qëllimi i aktit. Pjesët tjera do të udhëzohen si në vijim të këtij udhëzuesi.

Gjithsesi, gjatë hartimit aktit nën-ligjor Autoritetet Përgjegjëse kërkohet që të respektojnë dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative.<sup>5</sup> Meqenëse, ky udhëzimi administrativ ka për qëllim përcaktimin dhe unifikimin e standardeve për hartimin e akteve normative nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe Dispozitat e tij janë të detyrueshme për të gjitha institucionet dhe njësitë përkatëse të tyre si dhe të gjithë personat që marrin pjesë në procesin e hartimit, konsultimit, shqyrtimit dhe miratimit të akteve normative.

Tek përdorimi i shprehjeve në aktin juridik, institucioni t'i bëj referencë shprehjeve të përdorura në si nën Nenin 3 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, por jo të kufizohet në:

- **interesi privat i personit zyrtar** – nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste;
- **zyrtar i lartë** – nënkupton zyrtarët e lartë publikë të përcaktuar sipas Ligjit përkatës për deklarinimin, kontrollin dhe prejardhjen e pasurisë.
- **person zyrtar** – nënkupton çdo person tjetër të zgjedhur ose të emëruar në një organ shtetëror si edhe personat zyrtarë të përcaktuar sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës që ushtrojnë detyra publike dhe që nuk përfshihen në nën-paragrafin 1.3 të Nenit 3 të Ligjit.;

---

<sup>5</sup> Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Udhezim\\_Administrativ\\_Nr\\_032013\\_per\\_standardet\\_e\\_hartimit\\_te\\_akteve\\_norm....pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Udhezim_Administrativ_Nr_032013_per_standardet_e_hartimit_te_akteve_norm....pdf)

- **zyrtar** - nënkupton çdo zyrtar të lartë dhe çdo person zyrtar sipas nën-paragrafëve 1.3. dhe 1.4 të Nenit 3 të Ligjit;
- **person i afërm me zyrtarin** - bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jo pasuror me zyrtarin;
- **vendimmarrje** - çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik;
- **institucion** - përfshin institucionet publike të nivelit qendror dhe lokal, ndërmarrjet publike e nivelit qendror dhe lokal në të cilat ekziston pjesëmarrje e kapitalit shtetëror ose vendor dhe institucionet e tjera të themeluara me ligj;
- **autoritet përgjegjës** - nënkupton udhëheqësin e drejtpërdrejtë sipas hierarkisë, institucionet dhe autoritetet udhëheqëse sipas ligjit, si dhe personat përgjegjës të autorizuar brenda institucioneve përkatëse.

Në aktin juridik nën-ligjor duhet po ashtu të përdoren shprehjet tjera të cilat gjejnë përdorim në aktin në fjalë dhe për shkak të natyrës dhe fushë-veprimtarisë së institucionit mund të mos jenë të ditura për opinionin.



## *Detyrat dhe përgjegjësitë e Autoriteteve Përgjegjëse*

Të gjitha institucionet publike janë të obliguara të caktojnë zyrtarë përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit brenda institucioneve të tyre. Për shkak të natyrës dhe sfidave lidhur me rastet e konfliktit të interesit rekomandohet që në cilësinë e zyrtarëve përgjegjës të caktohen nëpunës nga Zyra e burimeve njerëzore apo Zyra Ligjore e institucionit përkatës.

Varësisht nga mandati, kompetencat, fushë-veprimtaria, numri i të punësuarve, funksioni dhe kompleksiteti i institucionit, si dhe faktorëve të tjerë, udhëheqësi i institucionit mund të marrë vendim për të caktuar një apo më shumë nëpunës në cilësinë e zyrtarëve përgjegjës për rastet e konfliktit të interesit brenda institucion - autoritetit përgjegjës.

Në kuadër të kompetencave të tyre, Autoritetet Përgjegjëse informojnë, këshillojnë dhe monitorojnë zyrtarët brenda institucionit të tyre në lidhje me situatat e mundshme të konfliktit të interesit, ndërmarrin masat parandaluese, si dhe raportojnë në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Në raste të veçanta, autoritetet përgjegjëse kërkojnë asistencë dhe ndihmë profesionale, këshilla apo sugjerime nga Agjencia Kundër Korrupsionit, me qëllim të menaxhimit dhe zgjidhjes sa më të mirë të rasteve konkrete të Konfliktit të Interesit.

Nga Autoritetet Përgjegjëse kërkohet që të ofrojnë seanca informative për zyrtarët e rinj në institucion në atë mënyrë që secili

zyrtar të marrë udhëzime për shmangien dhe adresimin e konfliktit të interesit. Për më tepër, këto autoritete janë të obliguara që të përdorin formularët e përgatitur nga Agjencia Kundër Korrupsionit në lidhje me rastet e deklarimit të konfliktit të interesit dhe formulari i regjistrimit të rasteve të konfliktit të interesit.

### AUTORITETI PËRGJEGJËS

- ✓ CAKTON ZYRTARIN (ZYRTARËT) PËRGJEGJËS;
- ✓ MBLEDH DHE PRANON NGA BURIME TË LIGJSHME INFORMATA PËR INTERESAT PRIVATË TË NJË ZYRTARI, PËRFSHIRË TË DHËNAT PUBLIKE OSE PRIVATE, INFORMATAT E OFRUARA NGA MEDIA DHE ANKESAT E QYTETARËVE SIPAS LIGJIT PËRKATËS PËR MBROJTJEN E INFORMATORËVE DHE ÇDO DISPOZITË TJETËR LIGJORE NË FUQI;
- ✓ VERIFIKON BESUESHMËRINË E BURIMEVE DHE INFORMATAVE PËR TË VËRTETUAR KONFLIKTIN E INTERESIT;
- ✓ VË NË DIJENI ZYRTARIN PËR INFORMATAT E SIGURUARA PËR TË DHE QË PËRBËJNË SHKAK PËR KONFLIKT TË INTERESIT DHE I JEP MUNDËSI TË PROVOJË TË KUNDËRTËN NËSE KJO KËRKOHET NGA ZYRTARI;
- ✓ NJOFTON ME SHKRIM RAPORTUESIN BRENDA AFATIT PREJ PESËMBËDHJETË (15) DITËSH PËR SHQYRTIMIN E MËTEJTMË TË INFORMATËS.



## *Kufizimet për zyrtarët e lartë publik dhe masat parandaluese të institucioneve publike*

---

Të gjitha institucionet publike – autoritetet përgjegjëse – obligohen që t'i referohen dispozitave në lidhje me kufizimet e zyrtarit të lartë pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Në këtë kontekst, fillimi i marrëdhënies së punës për zyrtarët e tillë është i ndaluar për rastet që përfshinë ky Nen.

Zyrtari i lartë nuk ka të drejtë të punësohet ose të emërohet, për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik, në pozitë udhëheqëse ose menaxhuese, apo të përfshihet në kontrollin ose auditimin e institucioneve publike dhe private dhe institucioneve vartëse të tyre të cilat kanë marrëdhënie biznesi me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik, nëse detyrat e tij gjatë periudhës dy-vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me mbikëqyrjen, kontrollin apo sanksionimin e aktivitetit të tyre.

Ashtu sikurse nuk ka të drejtë të:

- ⇒ të përfshihet në marrëdhënie kontraktore, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndonjë personi të afërm ose të besuar, me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik;
- ⇒ të përfaqësojë, ndihmojë ose këshillojë ndonjë person fizik ose juridik, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndonjë personi të afërm ose të besuar, në një konflikt ose marrëdhënie biznesi me institucionin, për detyrën që ai ka kryer ose që është në vazhdimësi të saj për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik; dhe
- ⇒ të përdorë informacionin e privilegjuar ose konfidencial të siguar gjatë ushtrimit të funksionit publik për qëllime e punësime të tjera në të ardhmen për interesin privat të vet ose të një personi të afërm apo të besuar për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik.

Institucioni në të cilën zyrtari i lartë ka ushtruar funksion publik nuk mund të bëjë biznes deri në një vit nga mbarimi i funksionit publik me subjektin në të cilin ish-zyrtari, personi i afërm me të apo personi i besuar kanë një pjesëmarrje prej jo më pak se pesë për qind (5%) në të drejtat e themeluesve, menaxhimin apo kapitalin, si me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet pjesëmarrjes së personave të tjerë juridikë.

Institucioni në të cilin zyrtari i lartë ka ushtruar funksion publik duhet, sa më parë por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë, të informojë Agjencinë Kundër Korrupsion për ndonjë

nga rrethanat e përmendura në paragrafin 1, të Nenit 18, të Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Çdo institucion apo udhëheqës i zyrtarit ose institucion udhëheqës merr masat e nevojshme, të përshkallëzuar dhe proporcionale për të shmangur paraprakisht dhe në çdo rast konfliktin real ose të mundshëm të interesave për shkak të zgjedhjes, emërimit apo caktimit të detyrave ose përgjegjësive të caktuara të zyrtarit. Këto masa përfshijnë por nuk kufizohen:

- kufizimin e informatave të caktuara për zyrtarin ose shmangien e detyrave dhe përgjegjësive që përbëjnë shkak në shfaqjen e konfliktit të interesit ose të papajtueshmërive;
- përjashtimin e zyrtarit nga pjesëmarrja në vendimmarrje
- rishikimin ose ndryshimin e detyrave dhe kompetencave të zyrtarit ose transferimin në një detyrë tjetër që mënjanon konfliktin e interesave, për aq sa nuk parashihet ndryshe me ligj;
- shmangien e emërimit ose të zgjedhjes së zyrtarit në funksione në të cilat ekzistojnë ose mund të lindin konflikte të interesave;
- revokimin ose anulimin e një akti të marrë në kushtet e konfliktit të interesave.

Pavarësisht këtyre masave bazë të mësipërme dhe çdo mase tjetër të paraparë me ligj, zyrtari ose udhëheqësi i tij sipas hierarkisë nuk përjashtohen nga përgjegjësia kur masat e marra nuk japin efekt në parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit ose papajtueshmërive sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Udhëheqësi ose institucioni udhëheqës njoftojnë Agjencinë Kundër Korrupsionit për masat e marra për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit ose papajtueshmërive sipas këtij ligji.

Çdo institucion apo udhëheqës i zyrtarit ose institucion udhëheqës duhet të sigurohet që zyrtari në ushtrimin e funksionit publik ka kryer këto veprime:

- ✓ transferon interesin privat dhe të drejtat në drejtimin e ndërmarrjes sipas përcaktimeve të nenit 15 të ligjit për konfliktin e interesit;

## MASAT PARANDALUESE

- ✓ PËRCAKTIMI I FILLIMIT DHE PËRFUNDIMIT TË MANDATIT TË ZYRTARIT;
- ✓ KUJDESI NË THEMELIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS ME ZYRTARIN (E LARTË);
- ✓ VETËDIJËSIMI PËR VEPRIMET E LEJUARA DHE TË NDALUARA NGA DHE ME ZYRTARIN.

- ✓ merr masa për vetë përjashtimin ose përjashtimin paraprak nga procesi i vendimmarrjes, diskutimit dhe votimit të çështjes në konflikt me përjashtim të rasteve të përcaktuar shprehimisht me ligj;
- ✓ jep dorëheqjen nga detyrat, funksionet ose veprimtaritë që janë në konflikt ose të papajtueshme me funksionin e tij publik;
- ✓ dorëhiqet nga funksioni publik.

Më tej, e njëjta bazë ligjore përcakton se çdo udhëheqës i zyrtarit ose institucion udhëheqës merr masat e nevojshme, të përshkallëzuara dhe proporcionale për të shmangur paraprakisht dhe në çdo rast konfliktin real ose të mundshëm të interesave për shkak të zgjedhjes, emërimit apo caktimit të detyrave ose përgjegjësi të caktuara të zyrtarit. Këto masa përfshijnë por nuk kufizohen:

- kufizimin e informatave të caktuara për zyrtarin ose shmangien e detyrave dhe përgjegjësi që përbëjnë shkak në shfaqjen e konfliktit të interesit ose të papajtueshmërive;
- përjashtimin e zyrtarit nga pjesëmarrja në vendimmarrje;
- rishikimin ose ndryshimin e detyrave dhe kompetencave të zyrtarit ose transferimin në një detyrë tjetër që mënjanon konfliktin e interesave, për aq sa nuk parashihet ndryshe me ligj;
- shmangien e emërimit ose të zgjedhjes së zyrtarit në funksione në të cilat ekzistojnë ose mund të lindin konflikte të interesave;
- revokimin ose anulimin e një akti të marrë në kushtet e konfliktit të interesave.

Pavarësisht masave bazë të mësipërme dhe çdo mase tjetër të paraparë me ligjin për parandalimin e konflikt të interesit, zyrtari ose udhëheqësi i tij sipas hierarkisë nuk përjashtohen nga përgjegjësia kur masat e marra nuk japin efekt në parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit ose papajtueshmërive sipas këtij ligji.

Udhëheqësi ose institucioni udhëheqës njoftojnë Agjencinë për masat e marra për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit ose papajtueshmërive Ligjin për Parandalimin e konflikt të interesit.

## *Veprimet e Autoriteteve Përgjegjëse gjatë trajtimit të rasteve*

---

Nga të gjitha institucionet kërkohet që çdo rast duhet të trajtohet me kujdes të veçantë. Kërkohet që të respektohen parimet e profesionalizmit, integritetit, konfidencialitetit dhe parimet tjera të nevojshme në trajtimin sa më efektiv dhe efikas të rasteve. Për secilën situatë të paraqitur të konfliktit të interesit, autoriteti përgjegjës regjistron identitetin e zyrtarit, interesat e tij private, arsyet për konfliktin e interesit dhe konfliktin ose papajtueshmërinë e gjetur, hisedarët, burimin e informacionit, si dhe vendimet e marra për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.

Autoriteti përgjegjës fillimisht përcakton se cilat janë mënyrat e pranimit dhe trajtimit të informata apo informacionit. Në këtë kontekst, Autoriteti përgjegjës mbledhë informacionet në lidhje me konfliktin e interesit nga burime të ndryshme. Më pas, kërkohet që informacioni të verifikohet sa herë që rrjedh nga burime të pa-identifikuara ose anonime të informacionit.

Autoritetet përgjegjëse janë të obliguara që të njoftojnë raportuesin për pranimin e informacionit brenda afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve për shqyrtimin e mëtutjeshëm të informatës.

Autoritetet përgjegjëse administrojnë dokumentacionin lidhur me rastet e trajtuara dhe plotësojnë regjistrin për rastet e konfliktit të interesit, i cili duhet të përmbajë të dhëna personale të zyrtarit (emri, mbiemri, datëlindja, si dhe të dhëna tjera), interesin privat të tij i cili ka qenë shkak për lindjen e konfliktit të interesit, palëve të interesuara, burimin e të dhënave dhe mënyrën e marrjes dhe verifikimit të tyre, si dhe të dhëna tjera relevante lidhur me rastin.

Autoritetet përgjegjëse pas trajtimit të situatës së konfliktit të interesit, dalin me një raport, sa i përket vlerësimit apo konstatimit të gjendjes.

Në rastet kur nevojitet përfshirja e Agjencisë Kundër Korrupsion, Autoriteti Përgjegjës obligohet të paraqes të gjitha informacionet e nevojshme të mbledhura, të cilat duhet të jenë të sakta dhe të verifikuara, e që pasqyrojnë gjendjen reale në lidhje me rastin për të cilin kërkohet asistencë profesionale.

## *Burimet e informacionit dhe verifikimi i tyre*

---

Autoriteti përgjegjës mbledhë informacionet në lidhje me konfliktin e interesit nga burime të ndryshme. Këto burime mund të jenë nga:

- ⇒ vetë zyrtari;
- ⇒ zyrtarë të tjerë apo nëpunës të institucioneve;
- ⇒ institucione të zbatimit të ligjit dhe institucione të tjera publike;
- ⇒ subjekte private dhe persona të tjerë;
- ⇒ mediet;
- ⇒ burime të tjera informacioni (baza e të dhënave, informacione të disponueshme për publikun, etj.).

Kërkoheq që informacioni të verifikohet sa herë që rrjedh nga burime të paidentifikuara ose anonime të informacionit.

Pas pranimit me shkrim të deklaramit rast pas rasti, autoriteti përgjegjës e regjistron atë, informon udhëheqësin e institucionit në lidhje me deklaramtën e pranuar dhe rrethanat e përmendura në të dhe inician procesin e verifikimit.

Gjatë verifikimit, autoriteti përgjegjës mbledh dhe merr informacion nga burime të ligjshme në lidhje me interesat private të një zyrtari, përfshirë të dhënat publike ose private, informacionin e dhënë nga mediet dhe ankesat e qytetarëve sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e informatorëve dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

Autoriteti përgjegjës verifikon besueshmërinë e burimeve të informacionit në mënyrë që të konstatoj ekzistimin e konfliktit të interesit dhe e vë në dijeni zyrtarin për informacionin e dhënë për atë që përbën bazën për konflikt interesi dhe i jep atij mundësinë për të provuar ndryshe nëse kërkohet nga zyrtari. Ky informacion për zyrtarin duhet të adresohet me shkrim, përveç në rastet kur duhet të jepet pa vonesë.

Kur janë mbledhur informacionet e nevojshme lidhur me rastin dhe sqarimet e zyrtarit, autoriteti përgjegjës përpunon raportin rreth rastit. Raporti duhet të përfshijë informacione të mbledhura nga burimet e ligjshme, gjetjet kryesore, shpjegimet e zyrtarit, rekomandimet rreth rastit dhe veprimet shtesë të përmendura më lartë.

Autoriteti Përgjegjës pas përfundimit të procedurës së verifikimit dorëzon Raportin përfundimtar tek udhëheqësi i Institucionit.

Në rast se udhëheqësi i institucionit zbulon se raporti nuk përmban dëshmi të mjaftueshme rreth konfliktit të interesit, rasti nuk është verifikuar si duhet ose

ekzistojnë pengesa tjera që nuk lejojnë marrjen e një vendimi, raporti së bashku me udhëzimet e duhura duhet t'i kthehen autoritetit përgjegjës për verifikime shtesë.

Në rast se udhëheqësi i institucionit zbulon se raporti nuk përmban dëshmi të mjaftueshme rreth konfliktit të interesit, rasti nuk është verifikuar si duhet ose ekzistojnë barrierat tjera që nuk lejojnë marrjen e një vendimi, raporti së bashku me udhëzimet e duhura duhet t'i kthehen autoritetit përgjegjës për verifikime shtesë.

Pasi që udhëheqësi i institucionit merr vendim rreth rastit autoriteti përgjegjës regjistron interesat private të zyrtarit dhe ndërmerri masa adekuate për zgjidhjen e konfliktit të interesit. Rezultatet e verifikimit i komunikohen Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Vendimet e marra gjatë procesit të verifikimit duhet të bëhen në përputhje me procesin administrativ në institucionet publike, të justifikohen, të jenë të bazuara mirë, të arsyeshme, me të drejtën e qartë të apelit dhe kushtet e aplikimit. Ky vendim duhet të adresohet me shkrim.

Nëse zyrtari nuk paraqet deklaratë rast për rast, por autoriteti përgjegjës merr informata për konfliktin e interesit aktual apo të mundshëm, ai i kërkon zyrtarit të dorëzojë deklaratën ose shpjegimin me shkrim. Në këtë rast, autoriteti përgjegjës gëzon të gjitha kompetencat e përcaktuara me ligj për verifikim, sipas këtij udhëzuesi për verifikim. Procesi i verifikimit është i njëjti si për deklarimin rast pas rasti.

Procesi i verifikimit duhet të regjistrohet (dokumentohet), veçanërisht - informacionet e marra nga burimet e informacionit dhe shpjegimet e zyrtarit. Të gjitha të dhënat (dokumentet) që shqyrtojnë rastin e veçantë të mblidhen në dosje të veçantë dhe të mbahen ndaras sipas rregullores së dokumentacionit. Qasja në këtë informacion dhe dokumentacion (dokumente) i jepet vetëm menaxhmentit të institucionit, autoritetit përgjegjës, Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe institucioneve të tjera shtetërore konform mandatit dhe kompetencave të tyre.

## *Veprimet e Autoriteteve Përgjegjëse në rastet e konfliktit të interesit*

---

Nëse gjatë verifikimit, autoriteti përgjegjës zbulon fakte që vërtetojnë shkelje të ligjit, ai duhet të përfshijë në vendim propozimin e veprimeve të mëtejshme duke shqyrtuar:

- sanksionet disiplinore;
- revokimin apo anulimin e një akti të ndërmarrë sipas kushteve të konfliktit të interesit;
- dorëzimin e materialeve tek agjencitë e zbatimit të ligjit për vendim të mëtejshëm mbi zbatimin e përgjegjësisë administrative ose penale;
- përgjegjësinë e zyrtarëve të cilët nuk kanë parandaluar konfliktin e interesit;
- analizën e shkaqeve të konfliktit të veçantë të interesit dhe propozimet për përmirësime në institucion në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesit ose përmirësime të tjera të nevojshme.



## *Identifikimi, trajtimi, deklarimin dhe regjistrimi 'rast për rast' i rasteve të konfliktit të interesit nga Autoritetet Përgjegjëse*

---

Për të gjitha situatat e paraqitura të konfliktit të interesit, autoriteti përgjegjës regjistron identitetin e zyrtarit, interesat e tij private, arsyet për konfliktin e interesit dhe konfliktin ose papajtueshmërinë e gjetur, hisedarët, burimin e informacionit, si dhe vendimet e marra për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.

Për qëllim të deklarimit 'rast për rast' të interesave private të zyrtarit, autoritetet përgjegjëse kërkohet të veprojnë në pajtim me Nenin 17 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Prandaj, gjatë hartimit të aktit nën-ligjor, Autoriteti Përgjegjës – Institucioni, kërkohet që të ketë parasysh se:

- ⇒ Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.
- ⇒ Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari, kur kjo kërkohet nga udhëheqësi ose nga institucioni udhëheqës apo mbikëqyrës. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e kërkesës ose e konstatimit të konfliktit të interesit.
- ⇒ Vetë-deklarimi ose deklarimi me kërkesë si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.
- ⇒ Për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, institucioni punëdhënës regjistron identitetin e zyrtarit, interesat private të tij, shkak për një konflikt interesi dhe konfliktin apo papajtueshmërinë e konstatuar, palët e interesuara, burimin e informatave, si dhe vendimet e marra për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.
- ⇒ Deklaratat për interesat private dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë konsiderohen dokumente zyrtare.

## *Raportimi në Agjencinë Kundër Korrupsion*

---

Autoriteti përgjegjës obligohet t'i raportojë Agjencisë Kundër Korrupsion menjëherë pas vendimit mbi rastin por jo më vonë se 15 ditë.

Përveç rasteve individuale, Autoritetet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji në institucione i dorëzojnë Agjencisë çdo vit për vitin pararendës, por jo më vonë se data 31 janar, një raport për veprimtarinë e kryer në zbatim të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, përfshirë rastet e konfliktit të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe statusin e trajtimit të tyre.

Raporti Vjetor për vitin paraprak i Autoritetit Përgjegjës përfshinë raste e konfliktit të interesit, veprimet e ndërmarra, masat parandaluese ose adresimi i tyre, rezultatet e arritura dhe statusin e lëndëve.

Agjencia kundër Korrupsionit publikon në faqen zyrtare të internetit një raport rreth aktiviteteve të ndërmarra në lidhje me rastet e konfliktit të interesit për të gjithë autoritetet përgjegjëse.

## *Roli Agjencisë Kundër Korrupsion në raport me Autoritetet Përgjegjëse*

---

Agjencia Kundër Korrupsionit është autoriteti qendror përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Si e tillë, Agjencia ndihmon Autoritetet Përgjegjëse në përgatitjen dhe përmirësimin e politikave, monitorimin e mekanizmave të parandalimit dhe shmangies së rasteve të konfliktit të interesit, si dhe detyrat të tjera konform mandatit të përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

Në raport me Autoritetet Përgjegjëse, Agjencia Kundër Korrupsionit:

- ⇒ Ofron ndihmë profesionale dhe teknike për këshillimin dhe mbështetjen e nismave ligjore dhe nënligjore të cilat duhet të ndërmerren nga institucionet për parandalimin e konfliktit të interesit;
- ⇒ Kryen hetime administrative në përputhje me procedurën administrative dhe jep rekomandime për forcimin e kapaciteteve për administrimin e interesave në institucione;
- ⇒ Ofron këshillim për zyrtarët e lartë të veçantë, udhëheqësve me kërkesën e tyre për rastet e caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, përfshirë këshillime të veçanta për personat zyrtarë sipas Ligjit, pasi janë shterur mjetet e brendshme në institucione punëdhënëse dhe kur gjykohet e domosdoshme përfshirja e Agjencisë;
- ⇒ Mban regjistrin për rastet e konfliktit të interesit dhe masat përkatëse të ndërmarra nga Agjencia dhe mbledhë informata të raportuara nga institucionet për regjistrat përkatës të deklarimit, trajtimit dhe zgjidhjes së rasteve të shfaqjes së konfliktit të interesit.

Për verifikimin dhe hetimin administrativ të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërive, Agjencia Kundër Korrupsionit ka të drejtë të shfrytëzojë informatat e nevojshme në të gjithë institucionet dhe në personat juridikë publikë e privatë, të cilët detyrohen të venë në dispozicion dhe/ose të sigurojnë qasje në informatat e kërkuara apo burimet e tyre në favor të Agjencisë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë.

Në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësisive të saj, Agjencia Kundër Korrupsionit shprehet me vendime, rekomandime dhe opinione.

Në procedurën administrative në lidhje me konfliktin e interesit, Vendimet e Agjencisë Kundër Korrupsion janë përfundimtare.

## *Përdorimi i formularëve*

---

Menjëherë pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia Kundër Korrupsionit ka miratuar Rregulloren Nr. 01/2018 të Punës së Agjencisë përmes së cilës ka aprovuar dy formularë:

- 1. Formularin për Deklarimin e Konfliktit të interesit;**
- 2. Formularin për Regjistrimin e Konfliktit të Interesit;**

Të dy këta formularë kërkohet që të zbatohen dhe përdoren nga të gjitha institucionet publike – autoritetet përgjegjëse.

Varësisht nga subjekti: (1) Formulari për Deklarimin e Konfliktit të interesit nënshkruhet nga zyrtari me rastin e marrjes së detyrës, punësimit, emërimit, caktimit të detyrës; dhe (2) Formulari për Regjistrimin e Konfliktit të Interesit shërben për institucionin – Autoritetin Përgjegjës në lidhje me regjistrimin e rasteve si dhe raportimin e tyre në fund të vitit tek Agjencia Kundër Korrupsionit.

Prandaj, kërkohet që këta formularë për përdoren nga Autoritetet Përgjegjëse, ose t'i bëhet referencë aktit nën-ligjor për përdorim të formularëve të tillë nga zyrtarët përgjegjës të institucionit përkatës.

## *Shtojcat e bashkëngjitura*

---

Udhëzuesit i bashkëngjiten Shtojcat si në vijim:

- ⇒ Vendimi për emërimin e autoritetit përgjegjës (Shtojca I);
- ⇒ Deklarata e interesave private të zyrtarit (Shtojca II);
- ⇒ Të dhëna nga rezultatet e verifikimit të konfliktit të interesit (Shtojca III);
- ⇒ Raporti i aktiviteteve të ndërmarra në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (Shtojca IV)

*Ky është Botimi i Parë i këtij udhëzuesi i hartuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit me të cilin synohet të mbështeten autoritetet përgjegjëse në punën e tyre, për identifikimin, trajtimin si dhe zgjidhjen e situatave të mundshme të konfliktit të interesit. Prandaj, si i tillë, varësisht nga sfidat apo problematika e paraqitur nga Autoritetet Përgjegjëse, Agjencia Kundër Korrupsionit ka të drejtë të rishikoj, ndryshoj, tërheq apo plotësoj këtë Udhëzues me qëllim të avancimit konform nevojave që mund të paraqiten gjatë procesit të punës. Ky udhëzues mund të shërbej për hartimin e akteve nën-ligjore konform Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në pajtim me udhëzimin administrativ për Standardet e Hartimit të Akteve Normative.*

*Përgatitur nga*  
Agjencia Kundër Korrupsionit

Prishtinë  
Shkurt 2020

## SHTOJCA I

(emri i institucionit dhe logo)

Nr. Protokollit:

Datë: / /

Në mbështetje të [baza ligjore e institucionit për nxjerrjen e vendimit] si dhe nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, [titulli i udhëheqësit të institucionit], nxjerr këtë:

### V E N D I M

#### **për emërimin e autoritetit përgjegjës**

1. Themelohet autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit në kuadër të [emri i institucionit].
2. Përbërja dhe struktura e autoritetit përgjegjës është si në vijim:
  - 2.1. Znj./Z. (emri dhe mbiemri), (pozita) si kryesues i autoritetit përgjegjës;
  - 2.2. Znj./Z. (emri dhe mbiemri), (pozita);
  - 2.3. Znj./Z. (emri dhe mbiemri), (pozita) si anëtarë të njësisë së autoritetit përgjegjës.
3. Për të përmbushur detyrat e tij në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesit, autoriteti përgjegjës është i autorizuar të:
  4. mbledh dhe merr informacion nga burime të ligjshme në lidhje me interesat private të një zyrtari, përfshirë të dhënat publike ose private, informacionin e dhënë nga mediet dhe ankesat e qytetarëve sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e informatorëve dhe sipas të gjitha dispozitave të tjera ligjore në fuqi;
  5. kërkojë nga zyrtari i përfshirë në hetimin e rastit të konfliktit të interesit të paraqesë informacione shtesë ose deklaratë të interesit privat të zyrtarit sipas kërkesës;
  6. regjistrojë interesin privat të zyrtarit;
  7. verifikojë besueshmërinë e burimeve dhe të informacionit në mënyrë që të provojë një konflikt interesi.
  8. verifikojë rastet e konfliktit të interesit dhe të vendosë nëse ka shkelje të dispozitave ligjore në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesit ose dispozitave të tjera ligjore;
  9. të marrë vendime në raste të veçanta, të propozojë veprime dhe aktivitete të mëtejshme në parandalimin e konfliktit të interesit në institucion, të informojë Agjencinë Kundër Korrupsionit;



10. informojë zyrtarët e rinj dhe të zhvillojë trajnime të rregullta të zyrtarëve dhe i këshillon ata për parandalimin e konfliktit të interesit

11. kryejë aktivitete të tjera në këtë drejtim nëse është e nevojshme.

12. Vendimi hyn në fuqi datën e nënshkrimit.

Nga ajo çfarë u tha si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në [emrin e institucionit], në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Emri & mbiemri**

---

pozita

Vendimi i dërgohet:

- *Anëtarëve të Autoritetit Përgjegjës dhe mbikëqyrësve të tyre të drejtpërdrejtë;*
- *Zyrës së [drejtorit, sekretarit, ministrit]*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Zyrës së Personelit;*
- *Arkivit.*

## SHTOJCA II

(emri i institucionit dhe logo)

Nr. Protokoli:

Datë: / /

Në mbështetje të Nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik:

### Deklarata e interesave private të zyrtarit

#### Pjesa A (plotësohet nga zyrtari)

Emri i institucionit	
Emri i zyrtarit (emri dhe mbiemri)	
Njësia dhe pozita	
Data e dorëzimit	
Hollësitë e kontaktit (numri i telefonit, email adresa, adresa)	

<input type="checkbox"/> Vetë-deklarimi	<input type="checkbox"/> Deklarimi me kërkesë
---	---

Interesat private të cilat shkaktojnë apo mund të shkaktojnë arsye për konflikt të interesit	
Përshkrimi i situatës së konfliktit të interesit apo konflikti i mundshëm i interesit	
Veprimet tashmë të ndërmarra për të zgjidhur konfliktin e interesit	
Propozimi për zgjidhjen e konfliktit të interesit	
Të dhëna shtesë (nëse ka)	

Unë... (emri dhe mbiemri) konfirmoj se të dhënat e paraqitura nga unë në këtë deklaratë janë të vërteta, të plota, të sakta dhe mbaj përgjegjësi ligjore për to:

..... (nënshkrimi, emri, mbiemri)

**Pjesa B (plotësohet nga autoriteti përgjegjës)**

Data e pranimit	
Autoriteti përgjegjës (pozita, emri, mbiemri)	
Numri i regjistrimit	

<p>Veprime të mëtejme: sanksionet disiplinore; revokimi apo anulimi i aktit; dorëzimi i materialeve tek agjencitë e zbatimit të ligjit (për shqyrtim të mëtejshëm mbi zbatimin e përgjegjësisë administrative ose penale); përgjegjësia e zyrtarëve të cilët nuk kanë parandaluar konfliktin e interesit; veprime të tjera (nëse ka).</p> <p>* Ju lutem, shpjegoni dhe justifikoni veprimet e propozuara apo refuzimin për ndonjë nga opsionet e përmendura.</p>	
Analiza e shkaqeve të konfliktit të interesit dhe propozimet për përmirësime	

Datë	
Nënshkrimi	
(Pozita, emri, mbiemri)	

### SHTOJCA III

(emri i institucionit dhe logo)

Nr. Protokolli:

Datë: / /

Të dhëna nga rezultatet e verifikimit të konfliktit të interesit

Emri i institucionit			
Numri i regjistrimit			
Emri i zyrtarit (emri dhe mbiemri)			
Njësia dhe pozita			
Data e paraqitjes së deklaratës apo informacioneve të pranuara		Data e vendimit	
Përshkrimi i rastit (të dhënat e pranuara, burimi i informacionit, personat e përfshirë, etj.)			
Vendimi i marrë dhe arsyetimi			
Analiza e shkaqeve të konfliktit të interesit dhe propozimet për përmirësime			
Pika e kontaktit (emri, pozita, numri i telefonit, email adresa)			

## SHTOJCA IV

(emri i institucionit dhe logo)

Nr. Protokolli:

Datë: / /

Raporti i aktiviteteve të ndërmarra në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik

Nr.	Rasti i konfliktit të interesit	Veprimet e ndërmarra për parandalim apo adresim	Rezultatet e arritura	Statusi i adresimit të tyre
1.				
2.				
3.				

Nr.	Aktivitete të tjera të ndërmarra nga institucioni parandalimin e konfliktit të interesit

Pozita, emri, mbiemri:

Hollësitë e kontaktit (telefoni, emaili)